

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR PRODHIMIN, TRANSPORTIMIN, TREGTIMIN E BIOKARBURANTEVE DHE TË LËNDËVE TË TJERA DJEGËSE, TË RINOVUESHME, PËR TRANSPORT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka si objekt promovimin e prodhimit dhe të përdorimit të burimeve të energjisë së rinovueshme për sektorin e transportit, nëpërmjet përdorimit të biokarburanteve për zëvendësimin e një pjese të nënprodukteve të naftës me lëndë djegëse jofosile për motorët me djegie të brendshme. Në këtë kuadër, Shqipëria është e angazhuar në kuadër të *acquis* të plotësojë objektivin kombëtar për energjinë e rinovueshme, ku pjesa e biokarburanteve zë 10% të këtij objekti, për konsum të burimeve të rinovueshme në nivel kombëtar me 38% në vitin 2020, krahasuar me vitin kur filloi detyrimi për MSA-në.

Në kuadër të INDC-ve (kontributit kombëtar të pikësnyuar) për reduktimin e gazeve me efekt serrë në sektorin e transportit, projektligji ka qëllim promovimin e kontributit në përmbushjen e angazhimeve për emetimet e gazeve që vijnë nga konsumi i hidrokarbureve në këtë sektor. Për Shqipërinë, transporti është kontribuesi më i madh i CO₂ dhe në përmasat e vendit, ndikon në ndryshimet klimatike. Ligji parashikon objektiva, afate kohore dhe role me përgjegjësi të përcaktuara qartë.

Qëllimi i projektligjit është të krijohen politika nxitëse për kultivimin e bimëve energjetike në Shqipëri, për të mbrojtur mjedisin nëpërmjet respektimit të kriterëve të qëndrueshmërisë për prodhimin e biokarburanteve, biolëngjeve dhe biogazeve ashtu siç janë parashikuar në direktivën 2009/28/KE, si dhe të plotësohen kërkesat e direktivës 2009/30/EC për cilësinë e karburanteve në transport. Kërkesa për këtë iniciativë ligjore lidhet dhe me faktin se ligji ekzistues nr.9876, datë 14.2.2008, “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”, është përpiluar në përputhje me direktivën 2003/30, e cila është zëvendësuar me kërkesa të direktivës 2009/28.

Qëllimi i veçantë i këtij projektligji është edhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve për dobinë e madhe që sjell në mjedis dhe në shëndetin e tyre konsumi biokarburanteve në sektorin e transportit, duke respektuar cilësinë e benzinës

dhe të gazoilit gjatë shtimit të biokarburanteve në procesin e përpunimit dhe të përzierjes.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektligji është i planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për vitin 2019, si dhe në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2019-2021.

Miratimi i këtij projektligji do të përbëjë një kontribut konkret të qeverisë shqiptare për mbështetjen e një politike kombëtare për nxitjen, promovimin e burimeve të energjisë së rinovueshme në sektorin e transportit. Ky projekt është përpiluar në përputhje të pjesshme me direktivën 2009/28/EC, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 7 tetor 2009, “Për promovimin dhe përdorimin e burimeve të energjisë së rinovueshme”, për aq sa lidhet me biokarburantet për përdorim për transport si pjesë e energjisë nga burime të rinovueshme.

III. PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME TË KËTIJ PROJEKTAKTI

Ligji biokarburanteve i vitit 2008 që përfshin dispozita që synojnë mbështetjen e përdorimit të burimeve të energjisë së rinovueshme në transport, nuk është zbatuar siç kërkohet (në ligj) vërtet në praktikë. Kjo për shkak se aktet nënligjore që duhet të dilnin për të mundësuar implementimin e këtij ligji nuk janë miratuar dhe, për rrjedhojë, objektivat e përcaktuar në të kanë qenë të pamundur për t’u realizuar.

Përparësia bazë e këtij projektligji është promovimi nëpërmjet politikave stimuluese, jo vetëm për prodhimin e biomasës në bujqësi, pasi është parashikuar përmbushja e kriterëve të qëndrueshmërisë, por edhe në teknologjinë e prodhim-përpunimit në mënyrë që në total të arrihet qëllimi i përcaktuar në objektivin kombëtar të konsumit të burimeve të rinovueshme të energjisë prej 38% në vitin 2020. Për këtë është i domosdoshëm konsumimi në territorin e Shqipërisë i sasisë prej 10% të biokarburanteve në volumnin e karburanteve dhe të lëndëve djegëse të rinovueshme, në sektorin e transporteve deri në fund të vitit 2020. Objektivat e vendosur në këtë projektligj janë të përshkallëzuar në mënyrë të tillë që edhe efektet ekonomike që shkakton zëvendësimi i një pjese të karburanteve në transport me biokarburante të jenë të pranueshme.

Gjithashtu, problematika lidhur me identifikimin dhe adoptimin e akteve nënligjore për qëndrueshmërinë, mënyrën e llogaritjes dhe llojin e informacionit që lidhet me prodhimin dhe përdorimin e biokarburanteve, të cilat janë parashikuar të realizohen me akte nënligjore, mbeten pikat më të rëndësishme në kuadër të angazhimeve që ka vendi ynë në dokumentin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si anëtare e këtij organizmi ndërkombëtar.

Ndër efektet e pritshme është arritja e objektivit kombëtar të konsumit të BER prej 38% në vitin 2020 dhe për këtë është i domosdoshëm konsumi në territorin e Shqipërisë i sasisë prej 10% në volum të karburanteve me bazë lëndë djegëse të rinovueshme (FAME), në sektorin e transporteve.

Nga ana tjetër pritet që të nxitet prodhimi i lëndëve të para për prodhimin e biokarburanteve, duke zbatuar kriteret e qëndrueshmërisë, të cilat njohin si lëndë të para energjetike, së pari, mbetjet me origjinë bimore dhe ato urbane, së dyti, përdorimin e tokës, sipas kriterëve përkatëse, për prodhimin e produkteve si lëndë e parë energjetike sipas kufizimeve të përcaktuara në këtë ligj, dhe së treti, transferimin e tyre në vende të tjera me certifikatë të gjelbër.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar është në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Ky projektligj vjen, gjithashtu, në përputhje me direktivën 2009/28/EC, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 7 tetor 2009, “Për promovimin dhe përdorimin e burimeve të energjisë së rinovueshme”, që ka ndryshuar direktivën 2001/77/EC dhe shfuqizuar direktivën 2003/30/EC, në përputhje me kërkesat e BE-së.

Ky projektligj shfuqizon ligjin nr.9876, 14.2.2008, “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Ky projektligj përafron pjesërisht direktivën 2009/28/EC, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 7 tetor 2009, “Për promovimin dhe përdorimin e burimeve të energjisë së rinovueshme”, për atë që lidhet me biokarburantet për përdorim për transport, si pjesë e energjisë nga burime të rinovueshme.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji është i ndarë në 3 krerë dhe përmban 20 nene, me përmbajtje, si më poshtë vijon:

Në nenin 1 “Qëllimi” përmbahen shpjegimet për atë çfarë synon të arrijë ky kuadër ligjor. Si qëllim kryesor është promovimi dhe përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë në sektorin e transportit.

Nëpërmjet nenit 2 “Fusha e zbatimit”, ky ligj zbatohet në veprimtaritë e prodhimit të biokarburanteve, nëpërmjet lëndëve të para djegëse, të rinovueshme, të cilat, në formë të pastër ose të përzier, në përqindje të caktuar me nënprodukte të tjera të përpunuara të naftës bruto, përdoren në sektorin e transportit për motorë me djegie të brendshme.

Ky projektligj zbatohet në veprimtarinë e përdorimit të biokarburanteve në sektorin e transportit kombëtar, kur biodiezeli dhe bioetanolli janë në përputhje me standardet evropiane, të përshtatura si standarde kombëtare nga organi kombëtar i standardizimit ose me standardet e tjera të barasvlershme me to.

Biokarburantet dhe biolëngjet duhet të plotësojnë kriteret e qëndrueshmërisë në përputhje me nenin 9, të këtij ligji.

Në nenin 3 jepen “Përkufizime”, të produkteve dhe karakteristikave që ato kanë etj.

Në nenin 4 si “Objektivat kombëtarë” janë 5 drejtime:

- a) Nxitja e prodhimit dhe e përdorimit të biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që plotësojnë kriteret e qëndrueshmërisë, të shprehur në përqindje;
- b) Garantimi i efektshmërisë optimale të punës së motorit;
- c) Kontributi në mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit;
- ç) Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorëve të bujqësisë, si stimul për zhvillimin rural dhe nxitje të punësimit duke respektuar kriterin e qëndrueshmërisë;
- d) Ulja e sasisë së emetimeve të ndotësve në ajër dhe të emetimeve të gazeve me efekt serrë, të çliruara nga veprimtaritë në sektorin e transportit.

Gjithashtu, është marrë parasysh që kontributi nga biokarburantet e prodhuara nga mbeturina, mbetje, materiale celulozike joushqimore dhe materialet

linjo-celulozike, konsiderohet të jetë dyfishi i asaj të prodhuar nga biokarburantet e tjera.

Neni 5 përcakton llojin e licencimit të këtyre veprimtarive si kategori VIII.1 të shtojcës së ligjit për licencat, si dhe monitorimin e kësaj veprimtarie.

Neni 6 trajton çështjet që lidhen me mënyrën e funksionimit të impianteve të prodhimit dhe përzierjes së biokarburanteve dhe/ose të lëndëve të tjera të rinovueshme për transport, duke u përqendruar në kërkesën për licencim në aktivitetin e prodhimit të biokarburanteve dhe përzierjes së tyre. Lloji i të dhënave, forma dhe afatet e dërgimit të tyre nga impiantet për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport, përcaktohen nga ministria përgjegjëse për hidrokarburet.

Neni 7 përcakton mënyrën e përgatitjes për tregtim të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme. Biokarburantet dhe lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme, mund të ruhen, të magazinohen, të transportohen dhe të tregtohen vetëm kur përmbushin standardet në përputhje me pikën 5, të nenit 6, dhe përcaktimet e shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 4, të këtij ligji, të cilat realizohen në depozita ose impiante magazinimi dhe transportimi të përshtatshme për këto lloj produktesh.

Neni 8 përcakton organizimin e tregut të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, e cila përcakton se veprimtaritë e importimit, të eksportimit dhe të tregtimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në formë të pastër ose në formë përzierjeje me nënprodukte të përpunimit të naftës bruto, realizohen nga njësitë e prodhimit të biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport dhe nga rafineritë e naftës të pajisura me leje koncesioni. Shoqëritë e pajisura me licencë të llojit A, për tregtimin me shumicë të nënprodukteve të naftës kanë të drejtë të tregtojnë nënprodukte të naftës me përzierje biokarburantesh, si dhe të realizojnë përzierje, pasi të jenë të pajisur me “Leje për përzierje”. Shoqëritë e tregtimit me pakicë të nënprodukteve të naftës, të pajisura me licencë, sipas dispozitave të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, kanë të drejtë të shesin me pakicë biokarburante në formë të përzier me nënprodukte të përpunimit të naftës bruto, duke zbatuar standardet shqiptare dhe dispozitat e këtij ligji. Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve shqyrton dhe përditëson në kohën e duhur në konsultim me palët e interesuara standardet e reja, të cilat duhet të jenë të njehsuara me ato evropiane.

Neni 9 përcakton kriteret e qëndrueshmërisë së biokarburanteve në përputhje me direktivën 2009/28/EC.

Neni 10 përcakton mënyrën e verifikimit të kriterëve të qëndrueshmërisë së biokarburanteve të detyrueshme për operatorët ekonomikë. Konkretisht, këta të fundit janë të detyruar:

- a) të lejojnë që sasi të lëndëve të para ose biokarburante me karakteristika të ndryshme qëndrueshmërie të përzihen;
- b) të informojnë mbi karakteristikat e qëndrueshmërisë dhe mbi volumet e përzierjeve të përmendura në shkronjën “a”, dhe t’i mbajnë ato të pandryshuara;
- c) të sigurojnë që shuma e sasive të përdorura nga përzierja të ketë të njëjtat karakteristika të qëndrueshmërisë, sa shuma e të gjithave volumeve që i janë shtuar përzierjes.

Neni 11 përcakton se zbatimi i kriterëve të qëndrueshmërisë së biokarburanteve do të fillojë nga data 1 janar 2020 e në vazhdim.

Neni 12 përcakton mënyrën e përlllogaritjes për përcaktimin e sasisë vjetore minimale të konsumit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.

Neni 13 përcakton procedurat bazë të lëshimit të “Lejes së prodhimit” dhe “Lejes së përzierjes”.

Neni 14 përcakton se organi shtetëror i specializuar për kontrollin e veprimtarisë së ushtruar nga personat juridikë, në përputhje me dispozitat këtij projektligji, është inspektorati shtetëror përgjegjës, që funksionon dhe është në varësi të ministrit përgjegjës për hidrokarburet.

Neni 15 përcakton se trajtimi fiskal i prodhimit dhe tregtimit të biokarburanteve bëhet sipas legjislacionit doganor dhe tatimor në fuqi.

Neni 16 përcakton rastet e kundërvajtjeve administrative dhe mënyrat e dënimit të tyre.

Neni 17 përcakton aktet nënligjore që duhet të nxjerrin Këshilli i Ministrave, ministritë përgjegjëse dhe konkretisht:

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet përkatëse nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 5, 7, pikat 2, 4 dhe 5, 12, pikat 2 dhe 7, 13, pika 1, dhe 15, pika 2, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për hidrokarburet që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet përkatëse nënligjore në zbatim të neneve 4, pika 2, 6, pika 7, 8, pika 4, dhe 12, pika 2, të këtij ligji.
3. Ngarkohet ministria përgjegjëse për transportin që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet përkatëse nënligjore në zbatim të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 4, të këtij ligji.
4. Ngarkohet ministria përgjegjëse për mjedisin që, brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet përkatëse nënligjore në zbatim të pikës 3, të nenit 9, të këtij ligji.
5. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda periudhës tranzitore deri në vitin 2020, të nxjerrë aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse në zbatim të pikës 2, të nenit 10, të këtij ligji.

Neni 18 përcakton një dispozitë kalimtare 6-mujore për licencimin e njësive të prodhimit dhe të përzierjes së biokarburanteve, të cilat operojnë aktualisht në treg.

Neni 19 shfuqizon ligjin aktual nr.9876, datë 14.2.2008, “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”.

Neni 20 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e projektligjit ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe institucionet në varësi të saj.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Me qëllim arritjen e objektivit kombëtar të konsumit të BER prej 38% në vitin 2020, është i domosdoshëm konsumimi në territorin e Shqipërisë i sasisë prej 10% në volum të karburanteve të lëndëve djegëse të rinovueshme (FAME) si burime të energjisë të rinovueshme në sektorin e transporteve. Sipas nenit 15, të

rishikuar të këtij projektligji, trajtimi fiskal i prodhimit dhe tregtimit të biokarburanteve bëhet sipas legjislacionit doganor e tatimor në fuqi dhe në këtë fazë është e pamundur të llogariten efektet financiare nga mospagimi i këtyre taksave.

KËSHILLI I MINISTRAVE